Project: Date ...... / ...... / 39

# Protokoll Nr 12

Ky protokoll mbahet sot me datë 29.12.2025, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë kati i dytë në godinën e Bashkisë për zhvillimin e mbledhjes së radhës për muajin Dhjetor 2025.

Në mbledhje marrin pjesë këshilltorët:

Lini Bitri, Zotjona Budoni, Ypazi Bollo,
Donika Stoso, Alketa Conaku,
Julian Uropi, Elona Stambollliu, Elmerina Sina
Xhorxhi Kraki, Indrit Zguna,
Ajete Mebelli,
Gjoport Apolli, Eldo Sinani,
Jurgen Smili, Mishel Verdha,
Sohit Strehimaj, Seit Kaja,
Lili Bitri, Adelajda Culi.

Meqenëse u plotësua kuorumi i këshilltorëve për zhvillimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit znj. Lini Bitri e deklaron mbledhjen të hapur.

Kalohet tek:

## Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 26.11.2025
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Nëntor 2025
4. Projektvendim për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2025
5. Projektvendim për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026.
6. Projektvendim për transferimin e disa funksioneve nga aparati i Bashkisë Divjakë në shoqërinë e krijuar me VKB nr 23 dt. 24.9.02 "Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" Rrjeta shpk dhe miratimin e Statutit dhe Aktit të themelimit.
7. Projektvendim për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK pronë DV dushje për lidhjen e kontratave para noterit
8. Projektvendim për miratimin e PBA 2026-2028, buxhetit të vitit 2026, numrit të punonjësve të bashkisë dhe nëndarjet vartëse të Bashkisë për vitin 2026.
9. Projektvendim mbi miratimin e kalendarit orientues për mено

Project: Date ...... / ...... / ..........

shpenzimeve e shpenzimeve vendore për PBA 2027-2029
10. Projektvendim për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë institucionet në varësi, të Nj. Adm dhe funksionet e deleguara v. 2026.
11. Projektvendim për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, institucionet në vartësi, dhe të Nj. Adm për v. 2026
12. Projektvendim mbi miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Divjakë për vitin 2026.

1. Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës
Kryetarja zj. Xin Bili i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje apo diskutime për rendin e ditës?
Pyetje nga këshilltarët s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2 - Pika e dytë e rendit të ditës
- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 26.11.2025
Pyetje për procesverbalin nuk ka, diskutime s'ka
Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3 - Pika e tretë e rendit të ditës.
- Informacion mbi zbatimin e UKB për muajin Nëntor 2025.
Kryetarja zj. Xin Bili i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje apo diskutime për pikën e tretë të rendit të ditës?
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Atëherë shprehet Kryetarja kalojmë tek raportet e komisioneve për shqyrtimin e projektvendimeve.
Relaton Kryetarja e Komisionit të Ekonomisë dhe financave zj. Fatjona Budani:
Komisioni i Ekonomisë dhe financave u mblodh më datë 24.12.2025, dhe pasi shqyrtoi projekt vendimet e paraqitura nga Bashkia vendosi:
- Kaloj për miratim projektvendimin për miratimin e fondeve që do të trajtohen nga fondi i kishtëruar deri 6% për muajin Nëntor 2025
- Kaloj për miratim projektvendim për transferimin

e disa funksionare nga gjorati i Bashkisë në Shqipëri e krijuar me VKB nr 23 datë 24.4.2025.
- Të kaloj për miratim projektvendimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave, të ndërtuar kombëtar pa uregjistruar në ASHK.
- Të kaloje për miratim projektvendimin për miratimin e PBA 2026-2028, Buxheti i v. 2026, numrit të punonjësve të Bashkisë dhe ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për v. 2026 me këto ndryshime: Tek pika 6 ndryshohet nr. maksimal i punonjësve nga 486 punonjës në 488 punonjës, njësia shpenzuese, B. Divjakë nga 371 punonjës në 373 punonjës. Ndryshimet ndodhë si rezultat i një gabimi njerëzor në përgatitjen e Pr. vendimit.
- Të kaloje për miratim projektvendimin mbi miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për PBA 2027-2029.
- Të kaloje për miratim projektvendimin për miratimin e nr. të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, të Nj. Adm dhe funksionet e deleguara për vitin 2026.
- Të kaloje për miratim projektvendimin për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, instit. në vartësi dhe Nj. Adm. për v. 2026 me këto ndryshime:
Në lidhjen Nr1 shtohet numri rendor 95 me pagën e pozicionit të punës "Kameraman" prej 45 000 Lekë. Ky ndryshim vjen si rezultat i gabimit njerëzor kur është hartuar projektvendimi nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.
- Të kaloje për miratim projektvendimin mbi miratimin e Planit të aktiviteteve të KB. Divjakë për vitin 2026.
- Relatori dhe Kryetarja e Komisionit të arsimit, Rinisë kulturës, sporteve dhe turizmit zj. Elmerina Sina e cila relatoi raportin e Komisionit i cili u mblodh më datë 24.12.2025 dhe pasi shqyrtoi projektvendimin vendosi: - Të kaloj për miratim projektvendimin për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional 2025-2026.
4- Pika e katërt e rendit të ditës
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2025.
Kryetarja zj. Lin Biti foli për relatimin të jep

Project: Date ...... / ...... / ..........

specialistes së shërbimeve sociale znj. A. Melishta e cila i propozon këshilltarëve të miratojnë familjet në nevojë të dala nga sistemi i pikëzimit për pikët e mjaftueshme, dhe që kanë aplikuar, pasi u është bërë dhe verifikimi në familje të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar (6%) për muajin Nëntor, 10 familje me fondin prej 49.402 lekë. Këto familje janë: Elisabeta Luli 10692 lekë, Afrudita Kupi 5840 lekë, Esmeralda Gjota 7920 lekë, Vitrina Sula 5840 lekë, Ymer Allajrami 1525 lekë, Alketa Meta 5227 lekë, Mimoza Krosniq 2178 lekë, Zef Kolndreu 4752 lekë, Bashkim Gjini 1525 lekë, Zeqir Zeqiri 3703 lekë.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

5- Pika e pestë e rendit të ditës. (dhe votohet)
- Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026.
Relatori z. A. Bullari, Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe i propozon këshilltarëve që të miratojnë dhënien e bursave për nxënësit që ndjekin klasën e dhjetë në shkollat e mesme të arsimit profesional publik 2025-2026, si vijon: Në Shkollën e mesme mekanike bujqësore "Hasan D Gime" Fushë-Krujë, 8 (tetë) nxënës të cilët plotësojnë kriteret sipas VKM Nr 666 dt. 10.10.2019 i ndryshuar me VKM nr 511 dt. 27.7.2022 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konviktet dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të përfitimit për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike. Këto nxënës janë:
1. Marius Ilir Aropi, 2- David Henon Thomaj 3-
3- Arnest Aleksander Kajku, 4- Melisa Kujtim Lenja
5- Frederik Denom Zeneli, 6- Bjordi Shehu Celerej
7- Klejdi Flamur Elezi, 8- Timoteo Bardhyl Xhepa. Ndërsa:
Në Shkollën e Mesme bujqësore "Rakip Kryeziu" Krujë të miratojnë dhënien e bursave nxënësve të mëposhtëm: 1- Ramiz Niko Tanagjini dhe 2- Anton

Enton Gjoni,
Ci dhjetë nxënësit e mësipërm të përfitojnë bursën e plotë sepse i plotësojnë kriteret sipas VKM.
Kryetorja znj. Lili Biti: A kemi pyetje?
z. Sokol Abrahimaj: Kërkesa nga prindërit janë 11, ju propozoni 10 bursa. Ky nxënës përse nuk përfiton bursë? Përgjigjet z. A. Bullari: Kërkesa e prindit z. Roland Leka për nxënësin (djalin) Bruno, është regjistruar në shkollën e mesme artistike "Onufri" Elbasan, ku kjo shkollë nuk përfshihet në listën e shkollave profesionale, ardhur me shkresë nga MEK dhe Inovacionit.
Pyetje z. Sel Lozo: A janë njoftuar të gjitha familjet që kanë fëmijë në klasën e 10 (dhjetë) dhe që vazhdojnë në shkollat profesionale?
Përgjigjet z. A. Bullari: Po. Janë njoftuar që në muajin Tetor 2025, ku dokumentacioni të arkivohej deri në datën 30 Nëntor 2025. Erdhi kësh. Xh. Sekreti.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Erdhi këshilltari Lili Biti.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës
- Për transferimin e disa funksioneve nga aparati Bashkisë Divjakë në shoqërinë e krijuar me VKB nr 23 dt. 24.4.2025 "Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Rrjela Shpk"
Relator Drejtori i financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola, ku i propozoi këshilltarëve: 1- Transferimin e disa funksioneve nga Bashkia Divjakë dhe Agjensisë së Shërbimeve komunale në shoqërinë e krijuar me VKB "Rrjela shpk me nipt M54721402H. Këto funksione janë: grumbullimi + transport i mbetjeve, administrimi e parkimit dhe kullës 360°, administrimi e tregjeve të lirë, 2- Transferimi i funksioneve sipas pikës 1 (Vote) shoqërohet me fondet përkatëse. 3- Numri fillestar i punonjësve të kësaj shoqërie do të jetë 25 punonjës. 4- Shoqëria "Rrjela shpk do të zhvillojë aktivitetin e saj në p/p me ligjin 9901 dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare,
5- Ambjentet dhe mjetet e punës do t'i kalojnë shoqërisë "Rrjela shpk me kontrat huapërdorje nga Bashkia Divjakë

Project: Date ...... / ...... / ..........

dhe Agjensia e Trajtimeve Komunale (sipas listës bashkë lidhur)
Pyetje: znj. Xin Biti: - Çfarë nënkuptojmë me administrim të tregjeve të lira.
Përgjigjet Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola. Janë tregjet që administron Bashkia në çdo njësi, që funksionojnë një herë në javë.
Pyetje: znj. Xin Biti Kryetarja: Në pikë të Pr. vendimit është bashkangjitur një listë ndihmëse me gabime përshkrimi të cilat i kalojmë kësaj Shoqërie, mendoj se nuk duhet të kalojmë asetet, sepse Projekt vendimi është vetëm për kalimin dhe transferimin e funksioneve. Do hartohet një Pr. vendim tjetër për kalimin e aseteve, transferimin e tyre kësaj Shoqërie.
Përgjigjet Drejtori i Financës dhe Buxhetit si dhe Kryetari i Bashkisë z. J. Gorrea.
z. Sahit Ibrahimaj: Edhe gabimet të Bashkisë janë dhe mund të jepen me kontratë huapërdorje, si mjetet ashtu dhe ndihmëset. Këto gabime janë bosh dhe kanë shumë vite pa u përdorur, mendoj se duhet të miratojmë këtë projekt vendim që të fillojë punë dhe funksionimin i kësaj Shoqërie. Pyetje të tjera s'ka. Diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 18 votë pro, 1 votë abstenim dhe asnjë votë kundër.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës
- Për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK pranë DV Durrës për lidhjen e kontratave pranë notert.
Kryetarja ia jep fjalën për relatim z. A. Ballon, përgjegjës i Sekt. Juridik dhe Prok. Publike.
Relaton z. A. Ballon për këtë projekt vendim ku i propozon këshilltarëve që të miratojnë përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë zyrës RPP për lidhjen e kontratave pranë noterit për qytetarin që ka aplikuar që është: Sali Hasan Alimuçaj lindur në Shënpremte, banues në Grabjan, ka aplikuar dhe ka

porositur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në pallatin e grabjeve shk. I, kati II, apartament i përbërë nga 1 dhome dhe 1 guzhinë me aneks të grabjeve. Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 15 vote pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e PBA 2026-2028, Buxhetit të vitit 2026, numrit të punonjësve të Bashkisë dhe Ndihmave vartëse të Bashkisë për vitin 2026.
Kryetarja znj. Lin Bitri i jep fjalën për relatim Drejtorit të Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola.
I propozon këshilltorëve të miratojnë:
1. Programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 për B. Divjakë faza finale si vijon:
- Parashikimi i të Ardhurave, në leke.
Burimet buxhetore Parashikim:

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Trashëgimi nga v. kaluar | 280.806.207 | 73.677.739 | 65.123.162 |
| (05) Të trashëg nga financ. huaj | 1525.684 | - - | - |
| (02) " " " financ. huaj | 1.799.608. | - | - |
| Të ardhura nga bur. vetë | 229.075.000 | 219.064.000 | 223.000.000. |
| Transf. e pakushtëz. përgj. | 310.931.388 | 323.367.813 | 337.401.789. |
| Niveli i rritjes pagave | 57.741.333. | 57.741.333 | 57.741.333 |
| Transf. e pakushtëz sektoriale | 189.221.220 | 189.221.220 | 189.221.220 |
| Totali | 1071.100.440 | 863.072.105 | 872.487.504 |
| Projekti Joinable financ. | 6.988453 | 6.675.237. | 0 |
| Transf. e kushtëzuar | 278.300.000. | 288.600.000 | 288.600.000 |
| Totali i të ardhurave | 1.356.388.893 | 1.158.347.342 | 1.161.087.504 |

- Shpenzimet sipas njësive shpenzuese grupi 00 janë:

| | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| - Bashkia Divjakë | 941.674.354 | 129.440.000 | 129.440.000 |
| - Agjencia Sh. Komunale | 136.414.539 | 740.307.342 | 743.047.504 |
| Totali | 1078.088.893 | 869.747.342. | 872.487.504 |

- Të miratojnë Planin e të ardhurave për vitin 2026 si vijon:
- Të ardhura të trashëg nga viti 2025 280.806.207 leke
- " " të trashëg financ. huaj (05) 1.525.684 leke
- " " " " " " (02) 1.795.603 "
- Të ardhura nga taksa + tarifa vendore 2026 229.075.000 leke

Project: Date ..../..../........

në lekë:

- Të ardhura nga transf. e pakushtëz. Granti 2026 310.931.388
- Transferta për T. Te nivelit të paspecif. " 57.741.333.
- Të ardhura nga transf. e pakusht. sektoriale " 189.221.220.
Financim i huaj 2026 6.988.453.
Të ardhurat gjithsej në lekë 1.078.088.893.

Fondi i kushtëzuar për emergjencat civile 3% e buxhetit me vlerë 32.342.667 lekë.

- Plani i Shpenzimeve për vitin 2026 si vijon në lekë:
- Shpenzime korente (600+601+602) 766.318.172
- Shpenzime kapitale 230+231 293.056.205.
- Fondi rezerve dhe fond emergj. (604+606) 18.714.516.
- Plani i Shpenzimeve sipas artikujve për v. 2026 si:

a. Pagat 600 404.727.579 lekë
b. Sig. Shoq. 601 67.566.840 lekë
c. Shpenz. operat. + mirëmb. 602 294.023.753 lekë
d. Për Investime 230+231 293.056.205 lekë
e. Për transferta 604-606 20.702.043 lekë
e/1 Për kontigjencën 11.471-274 lekë
e/2 Për fondin rezerve 6.743.246 lekë
e/3 Kontribut për KQ. 500.000 lekë.

Gjithashtu propozoj gjithashtu të miratoni numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë, të punonjësve të Nj. Adm e institucioneve buxhetore në varësi dhe të punonjësve të funksioneve të deleguara.
Për Bashkinë Divjakë gjithsej 488 punonjës nga të cilët
- B. Divjakë 373 punonjës, Agjensia e Ujësjellës Kanalizimeve
- le 115 punonjës.
Kryetarja znj. Lin Biti i drejtohet këshilltorëve:
A keni pyetje për pikën e tetë të rendit të ditës?
z. Sokol Tërzhiman: Miratimi i PBA 2026-2028 dhe Buxheti miratohen vetëm në një Projekt vendim?
Përgjigjet Drejtori i Financës: Po. vetëm në një pr. vend.
Çdo vit kemi këmbëngulur për projektet e investimeve që do të kryhen me zëra. A i keni me zëra rrugët që do shtrohen për çdo fshat?
Do dhatë vetëm një shifër Bleje binder dhe bleje çakulli për shtrim rruge dhe se çfarë rruge do të shtrohet nuk e dim se nuk ka projekte.
Vërejtja ime është se Buxheti i v. 2026 dhe PBA

2026-2028, investimet janë hartuar në projekte.
Është bërë planifikimi në total dhe në zëra.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorreja, duke
u shprehur se kemi hasur disa mospërputhje me pro-
jektet dhe me terenin faktik.
Pyetje z. Sahit Ibrahimaj: Sa për pastrimin e kana-
leve kulluese vaditës, kemi qenë në vitin 2024 dhe jeni
shprehur se nuk ka nafte dhe vaj për mjetet, si
dhe për këtë vit dhe për v. 2026 nuk janë planifikuar
me zëra pastrimi i tyre, si dhe nuk ka projekte kur
do punojnë mjetet që të planifikohet dhe karburanti
dhe vaji. Në rrugën Dershor, kanë duhej të
pastroheshin kanalet, kur faktikisht nuk kishte për
mjetet as vaj, as naftë. Përse nuk realizohen pro-
-cedurat e prokurimit në kohë?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë duke iu referuar
ligjit të prokurimeve publike, se procedurat e prok.
kanë afate dhe duhen të zgjidhen.
z. Sahit Ibrahimaj: Kemi propozuar për blerjen e
një makine policie, a është realizuar?
Po, është blerë makina dhe është vënë në
funksion të policis bashkiake përgjigjet Kryetari.
z. Sahit Ibrahimaj shtron problemin për ndërtimin
e Qendrës shëndetësore Gradishtë, duke u shprehur
që të bëjmë kërkesën Ministrisë së Shëndetësisë për
këtë. Diskuton Kryetari i Bashkisë për këtë problematikë
mbi urgjencat.
znj. Alketa Canaku: Shtroj problematikat që kemi
në lidhje me asnjë shërbim që nuk është kryer
në Qendrën shëndetsore Grabjan, sidomos dezinfektim
dhe furnizim me shtretër. Edhe në shkollën Grabjan
nuk është kryer asnjë riparim, lyerje, dezinfektim etj.
Përgjigjet Kryetari.
Kryetarja e Këshillit znj. Lin Biti i drejtohet
Këshilltorëve: Ju lutem bëni pyetje vetëm për
pikën e rendit të ditës, për buxhetin.
z. Gajort Agolli: Kam shqetësim të njëjtë me z. Sahit
Nuk i kemi detajuar me zëra si investimet dhe
shpenzimet, janë të përgjithshme tek zëri të tjera të trashëgua

Project: Date ...... /...... / ..........

Përgjigjet dhe sqaron Drejtori i financës dhe Buxh.

Tek përgjigja zëri është për shpronësimet dhe i sqaron që më të shumët për investime. Kanë proble-matika të ndryshme dhe janë investimet në proces, të mbartura nga viti e kaluara dhe i mbartur si të trashëguara.

z. Gjergji Apolli: Mendoj si pozicionist se zëri blerje bimësh për shtrim rrugësh duhet të shoqërohet me projektet për çdo rrugë sipas gështenjave e lagjeve, dhe sipas Njësive Administrative.

znj. Xin Bita pyetje: Numri i punonjësve nga 483 ka shkuar në 488 pse?

Përgjigjet Drejtori i Financës dhe Buxhetit: Janë 5 punonjës të qendrës së shërbimit social.

Në lidhje me investimet: A do të ketë për v. 2026 rrethim të shkollës 9-vjeçare Koli Sakos. A është planifikuar ndërtimi i palestrës së shkollës ku është e amortizuar?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Po përgatitem pro-jektet dhe do lidhim akt marrëveshje me FZH Shq. sepse janë disa investime që kërkojnë fonde të papërballueshme nga Bashkia.

Znj. Elda Simoni: Në pr. buxhet e v. 2026 a është parashikuar rruga e Cermë Sektorit. 2- A është e mundur një hapësirë për një kënd lojërash tek fusha e sportit / Cermë Sektor?

Përgjigjet Kryetari z. Josif Gorrea: Për pyetjen e parë po punojmë me FZH Shqiptar, ndërsa për këndin e lojërave është e pamundur se do të rrethohet dhe mik e ndryshojmë destinacionin.

z. Gjergji Apolli: A kemi të ardhura nga Grepa i peshkut, që e kemi miratuar 3 muaj më parë?

z. Josif Gorrea: Kryesore është që të sistemohen treguesit e peshkut, mos të shitet në rrugë, por të pastrojmë dhe mjedisin.

z. Qerim Shuli: Mendoj që të futet në buxhet edhe ndërtimi i fushës së sportit në Remas.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës

dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim!

9 - Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Për miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për PBA 2027 - 2029.
Relatori Drejtori i Financës dhe Buxhetit, duke e sqaruar këshilltarët për këtë kalendar orientues, se për çfarë shërben ai, dhe i propozoi këshilltarëve që të miratojnë kalendarin orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për PBA 2027 - 2029.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Institucioneve në varësi, të Nj. Adm. dhe funksionet e deleguara për vitin 2026.
Relatori Drejtori i Burimeve Njerëzore z. Dritan Dose duke i propozuar këshilltarëve që të miratojnë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë sipas strukturës organizative të Bashkisë Divjakë për vitin 2026 si vijon:
Në Administratën Qendrore e Bashkisë 139 punonjës
Në Agjensinë e Shërbimeve Komunale 115 punonjës
Në Njësin Adm. Terbuf 35 punonjës
Në Njësin Adm. Gradishtë 29 punonjës
Në Njësin Adm. Grabjan 21 punonjës
Në Njësin Adm. Remas 25 punonjës
Për miratimin numrin maksimal të punonjësve të funksioneve të deleguara si vijon:
Sektori i arsimit 73 punonjës, Sektori Pyjeve 1 punonjës.
Sektori i Rrugëve rurale 12 punonjës, Sektori Ujitjes dhe Kullimit 23 punonjës, Sektori i MBr Zjarr+Shp. 15 punonjës.
Pyetje: znj. Xin Biti: A ka mundësi një punonjës i deleguar të ndryshojë funksionin? Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.
Znj. Xin Biti: Mendoj se nuk ka lidhje. Drejtoria e Arsimit me Mirëqenien sociale dhe kudo që shpërndahet. Rreth këtij mendimi sqaroi Kryetari.

Project: Date ...... /...... / ..........

Pyetje znj. Xin Biti: Tek sektori Ujitje-Kullimi çfar ndryshimi ka linja kredive?
Përgjigjet dhe sqaron këtë problematik Kryetari.
Pyetje znj. Xin Biti: Në qendrën e shërbimit komunitar a janë të gjithë të profesionalizuar?
Përgjigjet dhe jep sqarimet e duhura Kryetari i Bashkisë.
Pyetje të tjera s'ka. Diskutime s'ka.
Hidhet në votim, pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vote pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës
- Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në varësi dhe të Nj. Adm. për v. 2026.
Relator Drejtori i Burimeve Njerëzore z. D. Bose për këtë projekt vendim dhe i propozon këshilltorëve të miratojnë nivelet e pagave të Bashkisë Divjakë, Nj. Adm. dhe Instit në varësi sipas lidhjeve nr. 1, nr 2, dhe nr 3 që i bashkë-lidhen këtij projektvendimi.
znj. Xin Biti: A keni pyetje?
z. Gojart Apolli: A mund të na i përshkruani kufijtë e pagave për çdo pozicion? Sikur pozicioni i Drejtorit, e njëjta klasë e grup, diku e kanë 120 000, diku e kanë 100 000. Pse? dmth i njëjti pozicion ka nivel page të ndryshëm?
Përgjigjet dhe jep sqarime sipas VKM për pagat Drejtori i financës dhe buxhetit, si dhe Kryetari i Bashkisë.
Pyetje: Kryetarja znj. Xin Biti: A ka dal VKM për pagën minimale për v. 2026. Po përgjigjet Drejtori i financës. Pyetje s'ka, diskutime të tjera s'ka.
Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vote pro, 1 votë abstenim dhe asnjë votë kundër.

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës
- Mbi miratimin e planit të aktiviteteve të KB Divjakë për vitin 2026.
Kryetarja i drejtohet këshilltorëve: Planin e keni lexuar

dhe mund të propozoni shtese apo peksime si dhe gjatë vitit mund të prezanohet me temo të tjera sipas situatave.
z. Sohit Ibrahimaj: Mendoj të bëjmë shkëmbim eksperience me Komunën e Prizrenit në Kosovë.
z. Xili Biti: Mendoj që të vizitojmë një Bashki në Zvicër. Asgjë tjetër s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e 12 e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
Kryetarja znj. Xin Biti propozon shtesë në rendin e ditës që të renditet në pikën e trembëdhjetë Projekt vendimi Nr. 92 datë 29.12.2025 "Mbi miratimin e një shtese fondi, ardhur nga MFE, në zbatim të aktit normativ Nr 11 dt. 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025". Ky projekt vendim të renditet në pikën e 13 të rendit të ditës. Hidhet në votim, miratohet me 18 vota pro.
13. Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.
- Mbi miratimin e një shtese fondi ardhur nga MFE në zbatim të aktit normativ nr. 11 datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 115/2024 për buxhetin e vitit 2025"
Për këtë projekt vendim relatoi Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkola, ku i propozoi këshilltorëve që ky fond të miratohet për shlyerjen e detyrimeve të papaguara tiranë me vlerën prej 10.553,085 lekë, ardhur nga Ministria e Financave me nr 18059/15 dt. 24.12.2025.
Kjo shtesë fondi do të përdoret për likuidimin e detyrimeve të papaguara në Bashkinë Lipjanë, por Agjencia e Mbetjeve Komunale nuk ka detyrime të papaguara.
Diskutoi z. Sohit Ibrahimaj: Jemi dakort me propozimin dhe të miratohet shtesa e fondit në buxhetin e vitit 2025 për likuidimin e detyrimeve të papaguara.
Diskutoi dhe Kryetarja e këshillit znj. Xin Biti, për këtë shtesë fondi që duhet të miratohet, sepse ka ardhur me destinacion për likuidimet e papaguara.
Asgjë të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e trembëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe

Project: Date ...... / ...... / ..........

osup votë abstenim.
Kalohet tek pika të tjera e cila është vendosur nga vetë këshilltarët.
Kryetarja ia jep fjalën këshilltarit z. Sahit Brahimaj
- Në Nëntor patë shumë përmbytje në toka të mbjella.
A jeni bërë verifikime nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë?
A jeni mbajtur procesverbale nga Komisioni i verifikimit të dëmeve të shkaktuara nga reshjet?
Mund të na vini në dispozicion dokumentacionin e mbajtur nga ana juaj?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. J. Gorrea: Është detyra jonë për të verifikuar dëmet, dhe do ju informojmë për çdo rast që mund të verifikoj komisioni i ngritur pranë Bashkisë.
- Ka ndodhur dhe një problematik me rënien e reshjeve të shumta, po shembeu rrugët dhe urat me tombino. A i keni verifikuar nëpërmjet komisionit të ngritur dhe a keni marrë masë për ndreqjen e tyre?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. J. Gorrea duke u shprehur: Po edhe ky problem po rregullohet.
z. Nazi Bollo: Në Qerime sektor kemi problem në drejtim të shëndetsis, nuk kemi doktor për vizita për familjet.
Përgjigjet Kryetari z. Josif Gorrea. Edhe ky është një fenomen në të gjithë vendin por mundohemi, kemi bërë kërkesa të vazhdueshme Ministrisë së Shëndetsise dhe jemi në pritje.
z. Gjergji Apolli: A keni marrë masa për dezifektimin e korkolecit se po shumohet?
Duhet të bëm kërkes Ministrisë së Bujqësise për këtë problematik se është emergjente.
znj. Alketa Caushi: Ujet janë ndarë paketat ushqimore për pensionistët dhe familjet në nevoje! Po si janë o po procedohet për këto ndihma me pako ushqimore?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. J. Gorrea
Po, kemi përpjestuar pako me ushqime dhe

kemi filluar shpërndarjen e tyre.
Janë verifikuar rreth 220 pako ushqimore, dhe këtë muaj kemi përfshirë jo vetëm pensionistët por edhe jetimët dhe invalidët.
Është ngritur grupi i punës për çdo njësi administrative si bashku me Administratorin e Njësisë dhe punonjësin e shërbimit social dhe po shpërndajnë paketat në çdo shtëpi sipas listës si verifikuar më parë.
Në këtë pikë diskuton dhe këshilltari z. Ajazi Bolla.
Diskuton Kryetari i Bashkisë dhe ve në dijeni këshilltarët për një projekt për strehimin e familjeve të pastreha dhe në gjendje tepër të vështirë ekonomike.
Në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit Shqiptar si për projektet ashtu dhe për fondet.
Pyetje z. Ajazi Bolla: Kush i ka marrë këto iniciativa?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: I kemi marrë ne, duke u mbështetur në kërkesat dhe verifikimet në terren të të gjithë familjeve në nevojë.
Kemi verifikuar disa godina të cilat mund të rikonstruktohen dhe të kthejmë në qendra komunitare për shërbim të komunitetit. Kemi kështu disa godina si në Ujrobjen, shkolla Mirë, e shumë të tjera që janë në vorhalimeri të verifikimit.
znj. Lin Bili: Në lagjen ku banoj, është amor tiruar rruga, dhe është gërryer nga shirat, me gropa të thella. A ka mundësi që të mbushen këto gropa?
Përgjigjet pjesën Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.
Pyetje të tjera s'ka.
Diskutime të tjera s'ka.
Kryetarja e Këshillit znj. Lin Bili e deklaron mbledhjen e mbajtur bëhjetor të mbyllur.
Procesverbali u mbajt nga sekretari i Këshillit të Bashkisë, dhe pasi u firmos nga

Project: Date ...... /...... / ..........

këshilltarët e pranishëm në mbledhje

Sekretari i KB
Mimoza Jehomaj

Kryetari i Këshillit të Bashkisë.
Arben Braçi

Mishel Veretha

Adelajda Gjika

Elmarina Gina

Alketa Gandaj

Neit Kapo

Elona Stambolliu

Nikita Halla

Indrit Kajana

Fatjon Sedani

Elda Simani

Iurgen Shtiçi

Ajola Mefolli

Fatjon Kapi